

# KËRKESË PËR RISHQYRTIM

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: **KOMUNA E ISTOGUT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

<b>Nr i Prokurimit</b>	<b>633-23-2733-1-1-1</b>
<b>Nr i brendshëm</b>	

Sa i përket tenderit për

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj **" GURI GROUP " SH.P.K.**  
NUI **810076358**  
Adresa **VRELLË ISTOG**  
Vendi **ISTOG**  
Kodi postar **31000**  
Numri Telefonit  
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj **Fatjona Bicaj**  
Adresa elektronike **gurigroup.prokurim@gmail.com**  
Data e parashtrimit të kërkesës **16.05.2023**

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-i  
Adresa elektronike t

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

**Njoftim mbi kontratë : 28.03.2023**

**Afati për dorëzimin e ofertave: 19.05.2023 - 14:00**

**Kriteret sipas FDT-së si në dosjen e tenderit**

#### **4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

Jo

#### **5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

#### **6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1 - Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

#### **7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Ju si AK edhe pas 3 korrigjimeve me formular B54 Formulari standard për korrigjimin e

gabimeve ne njoftimet e publikuara, kinse korrigjime gabimi, ende vazhdoni të mbani në këtë dosje tenderi kriteret diskriminuese që eliminojnë konkurrencën dhe pamundëson tenderimin e shumë OE si dhe favorizon kompani të caktuara. Kriter si:

#### 1. Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka filluar dhe përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njejtë ( Mirembajtje te rrugeve ,mirembajtje te projekteve infrastrukturore ) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë ne vlere min.400,000.00 euro.

Ndonëse vet emri i tenderit: RIPARIMI I RRUGEVE LOKALE TE RENDIT IV DHE SANIMI I GJENDJES NGA VERSHIMET.633-023-012-111. është riparim dhe sanim i gjendjes, si dhe bazuar në Paramasën e Tenderit që punimet duhet realizuar në riparim dhe sanim, ju AK Komuna Istog keni kërkuar referencë dhe kontrata të natyrës së njejtë (e që nuk ka të bëjë fare me këtë natyrë) Mirembajtje te rrugeve ose mirembajtje te projekteve infrastrukturore ndonëse me këtë tender duhej hequr borë apo duhet prerë bari rreth rruge apo duhet punuar shenjzimi horizontal me vija të bardha. Referenca të mirëmbajtjes së rrugëve kanë pak kompani dhe nuk ka të bëjë fare me natyrën e tenderit dhe si i tillë është diskriminues për shumë OE dhe ka qëllim eliminimin e konkurrencës, andaj, ju lutem ta largoni këtë kriter dhe t'a vendosni kërkesën për referenca të natyrës së projektit Ndërtim dhe Riparim rrugësh.

2. Ju AK (zyra e prokurimit) në Kërkesa 2 - Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme per realizimin e projektit keni kërkuar në fillim (para 3 koorrigjimeve) makineri aq specifike, me përshkrim të precizuar me qëllim favorizimi ose eliminim konkurrence. Edhe pas 3 korrigjimeve disa makineri ende mbesin pa nevojë dhe me qëllime të caktuara p.sh.

1. Dhjetë (10) Kamion veteshkarkues (kipper) me kapacitet min.10m3.
2. Dy (2) Ngarkues kapacitet min.3m3.
3. Nje (1) Grejder min 16 ton.
4. Dy (2) Cilindra min.12 tona vibrues
5. Dy(2) eskavator me zinxhir me peshe min 30 tona.

Këto makineri e kalojnë shëmë herë sasinë dhe kapacitetin punues të kërkuar me paramasë. Ju lusim që të korrigohet dhe të vendoset kriter si:

1. Pesë (5) Kamion veteshkarkues (kipper) me kapacitet min.10m3.
2. Një (1) Ngarkues kapacitet min.3m3. (sepse është dhe një tjetër me peshë min. 6 tona)
3. Grejder min 16 ton. të largohet sepse është kërkesë për një tjetër - Nje (1) Grejder min 10ton.
4. Një (1) Cilindër min.12 tona vibrues
5. Dy(2) eskavator me zinxhir me peshe min 20 tona. (punën e njejtë e bën si 20 tona si 30 tona).

Këto përmirësime të kriterëve janë të bazuar në mënyrën, llojin dhe sasinë e realizimit të komplet projektit me sukses dhe nuk kanë qëllim diskriminimin e asnjë OE.

## **8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Ne konsiderojme qe keni bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, si dhe damtime tjera në fitimin e pritur, vlerë të referencave, imazh dhe dëmtime tjera që mund të ndodhin.**

## **9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*